



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit



PLANI KOMUNAL PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË-PKEE

2016 -2022



Drenas
Qershor
2016

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	5
2.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
2.1.	Qëllimi dhe qëllimi i PKEE.....	7
2.2.	Korniza Ligjore.....	8
2.2.1	Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe Direktivat Evropiane.....	8
2.2.2	Kuadri Ligjor në Kosovë.....	8
3.	QYTETI I DRENASIT.....	9
3.1.	Drenasi.....	9
3.2.	Komuna e Drenasit.....	10
3.3.	Situata e furnizimit me energji elektrike dhe ngrohje në komunë.....	11
4.	TË DHËNAT E KONSUMIT ENERGJETIK.....	13
4.1.	Metodologjia e mbledhjes së të dhënave.....	13
4.2.	Stoku i ndërtesave publike.....	14
4.2.1	Stoku i ndërtesave administrative.....	14
4.2.2	Stoku i ndërtesave të arsimit.....	16
4.2.3	Stoku i ndërtesave të shëndetësisë.....	21
4.2.4	Stoku i ndërtesave të kulturës dhe sportit.....	23
4.3.	Ndriçimi Publik.....	24
4.4.	Përmbledhje e konsumit energjetik.....	26
5.	STRATEGJIA PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË.....	27
5.1.	Ndarja e resurseve financiare, organizative dhe humane për fushën e EE.....	28
5.2.	Vlerësimi i performancës energjetike	28
5.3.	Plani i Veprimit.....	28
5.4.	Zgjedhja e masave teknike.....	29
6.	VLERËSIMI I POTENCIALIT PËR KURSIM.....	33
6.1.	Potenciali për kursim në stokun e ndërtesave administrative.....	34
6.2.	Potenciali për kursim në stokun e ndërtesave arsimore.....	35
6.3.	Potenciali për kursim në stokun e ndërtesave shëndetësore.....	36
6.4.	Potenciali për kursim në stokun e ndërtesave të kulturës dhe sportit.....	36
6.5.	Potenciali për kursim në ndriçim publik.....	37
6.6.	Përmbledhje e potencialit për kursim energjetik në komunë.....	38
7.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	39
7.1	Matja e performancës.....	39
7.2	Rishikimi i Planit të Veprimit.....	39
8.	PËRMBLEDHJE.....	40

SHKURTESAT

PKEE	Plani Komunal për Eficiencën e Energjisë
EE	Eficienca e Energjisë
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
BE	Bashkimi Evropian
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
ZKE	Zyra Komunale për Energji
ASK	Agjensia e Statistikave të Kosovës
REKOS	Regjistrimi i popullësisë 2011
MWh	Megavat/orë
ktoe	Ekuivalent i Kiloton Naftës
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NMV	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
EC	Komuniteti Evropian

KONTRIBUESIT

Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë i komunës së Drenasit është hartuar nga Shoqata SH.E.E.R dhe Grupit punues për rishikimin e planit komunal për eficiencë të energjisë.

Këshillimi dhe rekomandimet:

Agjësia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë

1

HYRJE

Komuna e Drenasit synon të ndërtoj një të ardhme ku do të reduktohej lirimi i gazrave të dëmshme dhe do të minimizoheshin shpenzimet komunale me ndihmën e eficiencës së energjisë dhe burimeve të ripërtitshme të energjisë. Me Planin Komunal për Eficiencë të Energjisë, komuna jonë i bashkëngjitet iniciativës mbarëbotërore për energji të pastër dhe të qëndrueshme për të ardhmen. Republika e Kosovës është palë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ndër objektivat e të cilit është edhe rritja e eficiencës me të cilën shfrytëzohet energjia. Në Planin e Veprimit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (2010-2018) është vendosur caku indikativ i kursimit deri 9 % të konsumit total mesatarë energjetik apo 91.89 ktoe deri në vitin 2018^[1].

Me rishikimin e PKEE, Komuna e Drenasit do të zotohet me qëllim të kursimit prej 27% të konsumit total të energjisë (mesatar për vitet 2016, 2017 dhe 2018) deri në vitin 2022 në stokun e ndërtesave publike dhe ndriçim publik, sektorë këto nën menaxhimin e drejtpërdrejt të Komunës, dhe ky plan, PKEEi llojit të vet për komunën e Drenasit, do të shërbej si udhëzues për arritjen e këtij qëllimi.

Gjendja e tanishme e eficiencës së energjisë në qytetin e Drenasit lë shumë për tu bërë. Nëpërmjet ndërmarrjes së një vargu të masave për përmirësimin e kësaj gjendjeje, ne si Komunë kemi për qëllim që në radhë të parë të reduktojmë shpenzimet për shërbime energjetike por edhe për të shërbyer si një model për qytetarët tonë në të mirë të afirmimit të eficiencës së energjisë.

Hartimi i PKEE bartë në vete një numër të përparësive në fusha të ndryshme ekonomike, energjetike dhe mjedisore nëpërmjet informimit të autoriteteve lokale mbi konsumin e tyre energjetik dhe identifikimin e mundësive për kursim të saj.

Përfitimet nga Eficienca e Energjisë është baze kursimi i energjisë, ruajtja e mjedisit zhvillimi ekonomik dhe ngritja e komfortit, ky është kuptimi i eficiencës së energjisë.

2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky plan adreson konsumin energjetik në stokun e ndërtesave dhe ndriçimin publik në pronësinë dhe nën menaxhimin e Komunës së Drenasit. Në tabelën vijuese është dhënë numri i objekteve dhe i rrugëve të ndriçuara për secilin sektor të ndërtesave publike, përkatësisht ndriçimin publik në komunën e Drenasit.

Tab.1 Numri i objekteve dhe i trupave ndriçues për të cilat është bërë mbledhja e të dhënave të konsumit

Sektori	Numri
Ndërtesat administrative	6
Ndërtesat arsimore	35
Ndërtesat shëndetësore	13
Ndërtesat kulturore & sportive	4
Ndriçimi publik posedon 410 trupa ndriçues kryesisht 354 cope 150W dhe 60W	410

Në kuadër të komunës përveç sektorëve të sipërpërmendur, si konsumator fundor energjetik janë identifikuar edhe:

- Stoku i ndërtesave rezidenciale
- Stoku i ndërtesave komerciale
- Transporti

Për sektorët e mësipërm, për shkak se Komuna nuk ka juridiksion në menaxhimin e konsumit energjetik, nuk ka qenë e mundur mbledhja e të dhënave për to.

Më poshtë janë paraqitur të dhënat e mbledhura për konsumin energjetik mesatar për vitet (2014 dhe 2015), të dhëna këto të siguruar nga grupi punues i KK Drenas. Në bazë të këtyre të dhënave, të cilat sigurojnë një pasqyrë gjeneralë të gjendjes së sektorëve të ndryshëm komunal nga aspekti i konsumit energjetik, është vlerësuar se në komunën e Drenasit ekziston potenciali për kursim energjetik i dhënë si më poshtë:

Tab.2 Përmbledhje e potencialit për kursim të energjisë dhe investimi i nevojshëm

Sektori	Kursimi [MWh/vit]	Kursimi [%]	Reduktimi i CO2/t/vit	Investimi [euro]
Ndërtesat administrative	92.87	35	170.68	92,876.48
Ndërtesat arsimore	2,655.17	35	1,241.06	952,302.72
Ndërtesat shëndetësore	238.61	30	181.24	146,080.00
Ndërtesa e kulturës/sportit	3.92	35	5.13	70,625.00
Ndriçimi publik	151	80	0.197	90,000.00
Totali	3,141.57	42	1,645.69	1,351,884.20

Për të arritur një kursim kumulativ prej 40% të konsumit total mesatar për stokun e ndërtesave publike dhe ndriçimin publik është paraparë një investim i nevojshëm prej rreth 1,351 milion eurosh deri në vitin 2022, kjo vlerë është bazuar mbi bazën e përqindjes të ndërtesave të rinovuar që është vlerë e përafërt, dhe duke ju referuar, studimit për vlerat njësi të investimit të masave teknike në stokun e ndërtesave publike, që janë shfrytëzuar të dhënat e ofruara në raportin e Institucionit të Bankës Botërore[4]. Vlerat njësi të llogaritura si kosoto-efektive për stokun e ndërtesave në Republikën e Kosovë.

Megjithëqë atë investimi i sakte do të dihet atëherë kur behën Aditimet e energjisë në stokun e ndërtesave në KK Drenas.

Këtë kursim energjetik synojmë që ta arrijmë nëpërmjet ndërmarrjes së masave organizative (vetedijesuese), legjislativë, teknike dhe pilot projekteve të ndryshme duke siguruar financimin e nevojshëm qoftë nëpërmjet grandëve qoftë nëpërmjet investitorve super ESCO dhe investimeve vetanake komunale.

2.1 Vizioni dhe qëllimi i PKEE

Komuna e Drenasit do punojë në mënyrë të vazhdueshme për të hulumtuar dhe implementuar alternativa për përmirësimin e eficiencës me të cilën shfrytëzohet energjia në objektet dhe veprimtaritë nën menaxhimin e saj me qëllim të reduktimit të shpenzimeve operacionale, optimizim të shërbimeve, reduktim të emetimit të gazrave të dëmshme dhe rritjen e kualitetit të jetës në komunitetin tonë.

Objektivat e përgjithshme të PKEE-së janë që të reduktoj konsumin e energjisë në Stokun e Ndërtesave publike, sipas kërkesës, në funksionimin e shërbimeve komunale përmes reduktimit të barrës së kostos së energjisë në buxhetet komunale. PKEE pritet që vijim të ketë ndikim në gjendjen e Komunës së Drenasit:

- ☐ Përmirësimin e shërbimeve komunale.
- ☐ Reduktimin e kostove të energjisë në buxhetin komunal.

- ☐ Renovimin e sistemeve të energjisë dhe ndërtesave.
- ☐ Përmirësimin e kushteve sanitare dhe rritjen e produktivitetit.
- ☐ Ngritjen e vetëdijes për kursimin e energjisë te vendimmarrësit, operatorët,
- ☐ dhe përdoruesit e fundit.
- ☐ Reduktimin e emetimeve të dëmshme nga përdorimi i burimeve të energjisë;

2.2 Korniza ligjore

Masat e parashikuara në PKEE janë në përputhje me ligjet valide për energjinë, Planin e Veprimit Mjedisor dhe me rregulloret komunale, veçanërisht me:

1. Ligjin për Energjinë (03/L-184). Përcakton çart rolin e qeverisjes lokale, i cili në një nga nenet e tij thotë: Organet e qeverisjes lokale duhet që në dokumentet e tyre zhvillimore të planifikojnë nevojat dhe mënyrën e furnizimit me energji dhe ato dokumente t'i harmonizojnë me Strategjinë e Energjisë,

2. Programin për Zbatimin e Strategjisë dhe balanceve të energjisë,

3. Ligjin për Eficiencën e Energjisë. Ligji i Kosovës për Eficiencën e Energjisë (ligji Nr. 04/L-016) përcakton përgjegjësitë e reja që do të kenë komunat në të ardhmen e afërt në lidhje me menaxhimin e energjisë dhe ujit dhe çështjet e lidhura me ato. Sipas këtij ligji, institucionet arsimore, të shëndetit publik, shërbimit social dhe të tjera së bashku me veprimet e mbrojtjes mjedisore, do të jenë nën bashkpërgjegjësinë e qeverisjes lokale dhe qendrore. Gjithashtu, komuna është përgjegjëse për projektimin dhe implementimin e politikave rajonale, e cila është një atribut i rëndësishëm në lidhje me politikat energjetike

Republika e Kosovës u bë anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë me nënshkrimin e tij nga UNMIK-u në vitin 2005. Në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, që nga 2005 ka ekzistuar nënsektori për fushat e EE dhe BRE në kuadër të Departamentit të Energjisë.

AKEE, e themeluar në prill të vitit 2012, paraqet institucionin kryesor përgjegjës të Republikës së Kosovës për fushën e EE, ndërsa Plani Kombëtar i Veprimit i Kosovës (PKEE) është dokumenti bazë për zhvillimin e politikave për eficiencë të energjisë në Kosovë.

PËRFITIMET E PRITURA NGA PKEE

Përfitimet e pritura nga implementimi i PKEE-së janë:

- Përfitime financiare
- Përfitime operacionale
- Përfitime mjedisore

2.2.1 Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe Direktivat Evropiane

Republika e Kosovës është palë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë që nga tetori i vitit 2005. Ky traktat synon krijimin e një tregu të përbashkët energjetik ndërmjet Komunitetit Evropian dhe palëve kontraktuese. Në mesin e objektivave të tjera të këtij traktati është edhe përmirësimi i eficiencës së energjisë dhe gjendjes së mjedisit si dhe rritjen e shfrytëzimit të burimeve të ripërtrishme të energjisë.

Disa nga direktivat e BE-së për fushën e eficiencës së energjisë janë:

- Përformanca energjetike e 2010/31/EU ndërtesave
- Direktiva për eficiencë të energjisë të konsumatorëve fundor dhe për shërbime Energjetike 2016/32/EU
- Etiketimi energjetik i pajisjeve shtëpijake 2010/30/EU

2.2.2. Kuadri ligjor në Kosovë

Institucionet bazë përgjegjëse për drejtimin e Sektorit të Energjisë në Kosovë janë Ministria e Zhvillimit Ekonomik (ish Ministria e Energjisë dhe Minierave-MEM) dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRE). Përveç institucioneve qeveritare, entitetet tjera të cilat kanë ndikim të madh në Sektorin e Energjisë janë kompanitë e mëdha energjetike. Kompanitë dominuese në këtë sektor janë: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Republikës së Kosovës (KOSTT) dhe Kompanitë e Ngrohjes nga Largësia (në Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë). Aktualisht të gjitha kompanitë relevante energjetike kanë statusin publik dhe janë të drejtuara nga institucionet qendrore ose ato lokale.

Një mori dokumentesh ligjore të draftuara dhe implementuara nga institucionet qeveritare të cekura më lartë synojnë rregullimin e Sektorit të Energjisë dhe ofrimin e bazës për planifikimin e aktiviteteve strategjike në fushën e Energjisë. Në vazhdim do të prezantohen ligjet, udhëzimet administrative, rregulloret dhe dokumentet strategjike më të rëndësishme të publikuara gjer më tani.

Ligjet:

Ligji 03/L-184 për Energjinë,

Ligji 03/L-201 për Energjinë Elektrike,

Ligji 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë,

Ligji 04/L-016 për Eficiencën e Energjisë,

Ligji 03/L-133 për Gazin Natyror,

Ligji 03/L-116 për Ngrohje Qendrore,

Ligji 2004/5 për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës

Ligji Nr. 02/L-89 Për plotësim ndryshimin e Ligjit 2004/5 për Naftë dhe Derivate të Naftës,

Ligji Nr. 03/L-138 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2004/5 për Tregtinë me Naftë dhe dhe Derivate të Naftës në Kosovë,

Ligji 04/L-110 për Ndërtim,

Ligji 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit,

Ligji 2003/14 për Planifikim Hapësinor,

Ligji Nr. 03/L-106 për Ndryshimin e ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 2003/14,

Ligji 03/L-230 Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor,

Ligji 03/L-214 Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis,

Ligji Nr. 02/L-14 Për produktet e Ndërtimit.


Nga të gjithat ligjet e cekura më lartë, peshën më të madhe për rregullimin e Sektorit të Energjisë e kanë katër ligjet e para të cilat do të komentohen shkurtimisht në vijim.

3 QYTETI I DRENASIT

3.1 Drenasi

Komuna e Drenasit, ka një sipërfaqe prej 275,60 km² ose 27.449,10 ha, me një lartësi mbidetare prej 575 m pika më e ulët dhe 1072 pika më e lartë. Komuna e Drenasit bënë pjesë në grupin e komunave të mesme të vendit dhe shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Territori i saj , shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Territori i Komunës së Drenasit është një urë lidhëse në mes të këtyre dy rajoneve.

Territori i Komunës së Drenasit rrethohet me Malet e Berishës në pjesën Jug- Perëndimore, Kasmaqit në pjesën perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug- Lindore. Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së lumit Drenica. Sipërfaqet e tokës së Luginës së Drenicës i përshkon sistemi i ujitjes “Iber Lepenc”. Drenasi ka klimë të mesme kontinentale, me verëra të nxehta dhe dimra të ftohtë. Reshjet atmosferike mesatarisht sillen prej 499 – 675 l/m2. Lartësia më e ulët mbidetare është 380m te “ Dheu i bardhë”, kurse ajo më e larta është 1223m te “ Guri i Zi”. Erërat më të shpeshta janë ato veriore, ndërsa më të rrallat janë ato jugore.



3.2 Komuna e Drenasit

Organi më i lartë i Komunës është Kuvendi Komunal i cili miraton Statutin si aktin më të lartë juridik të pushtetit lokal.

Ekzekutivi i Komunës së Drenasit udhëhiqet nga Kryetari i Komunës dhe përbëhet nga 10 drejtori:

- Administrata e Përgjithshme
- Drejtoria e Arsimit
- Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa
- Drejtoria për planifikim Urban dhe mbrojtje të Mjedisit
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Drejtoria për Inspektorat
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

3.3 Situata e furnizimit me energji elektrike dhe ngrohje në komunë

Edhe komuna e Drenasit, ngjashëm me pjesën tjetër të komunave të Kosovës, ballafaqohet me sfidën e krijimit të institucioneve lokale për fushën e energjisë të cilat do të ishin drejtpërdrejt përgjegjëse për implementimin e kornizës ligjore në fushën e EE. Përveç mungesës së Zyrës Komunale për energji, është e domosdoshme edhe ndarja e një fondi për EE nga buxheti komunal.

Sa i përket rrjetit të energjisë elektrike, komuna e Drenasit është mirë e mbuluar, megjithatë është evidente nevoja për rritjen e kapaciteteve të tij. Rrjeti i energjisë elektrike në komunën e Drenasit përbëhet nga linjat e tensionit të lartë, të mesëm, të ulët dhe trafostacioneve.

Në lidhje me konsumin e energjisë në komunën e Drenasit deri më tani nuk janë kryer studime apo përmbledhje të të dhënave gjithëpërfshirëse në lidhje me konsumin përfundimtar të energjisë. Në komunë nuk ekziston zyra për energji apo edhe menaxher i energjisë me detyrë të vetme hartimin e planeve dhe projekteve për kursimin e energjisë, por vetëm koordinator për energji i cili krahas detyrave tjera të përcaktuara me planin e punës ka edhe detyrat mbi EE.

Energjia elektrike e konsumuar në komunën e Drenasit është ekskluzivisht e furnizuar nga linja elektrike 35 kV, deri në qendrën transformatorike në Drenas dhe prej aty shpërndahen në rrejtin shpërndares (10-20)kV dhe 0.4 kV nëpër lagje. Distributori krye-sor për energji është KEDS-i. Ndriçimi i rrugëve është tërësisht i kyçur në rrjetin ekzistues elektrik dhe nuk ka trupa ndriçues të lidhur me burime të ripërterishme.

Në qytetin e Drenasit nuk ekziston ngrohtore e qytetit. Ndërtesat komunale kanë në shumicën e rasteve kaldajat e tyre vetanake për ngrohje të cilat përdorin kryesisht dru-rin dhe thëngjillin si lëndë për djegie ndërsa më pak përdoret nafta.

Ndërtesat rezidenciale përdorin drurin dhe thëngjillin si lëndë për djegie por edhe ener-gjinë elektrike.

Nuk ka sistem të gazit të instaluar në forma rrjeti komunal dhe as lokal në ndërtesa.

Nuk ka burime alternative për prodhimin e energjisë nga burimet e renovueshme.

Në komunën e Drenasit ekziston shkretorja "Feronikelit" i cili është konsumator i priv-eligjuar i KEDS-it ngase përdorë sasi të madhe të energjisë. Një pjesë e kesaj energjie lirohet nga kullat e ftohjes të kompleksit industrial. Kjo duhet shikuar si mundësi për të ardhmen në lidhje me instalimin e impianteve për Koogjenerim.

4 TË DHËNAT E KONSUMIT ENERGJETIK

4.1 Metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Komuna e Drenasit deri më tani nuk ka ndonjë sistem të mbledhjes, strukturimit dhe analizës së të dhënave mbi konsumin energjetik në ndërtesat dhe sektorët nën pronësinë dhe menaxhimin e saj. Me qëllim të krijimit të një pasqyre mbi konsumin energjetik në sektorë të ndryshëm komunal, Grupi punues ne drejtoritë përgjegjëse të komunës kanë siguruar të dhënat mbi këtë konsum për vitet 2014 dhe 2015, në këto sektorë të dhënat janë siguruar edhe nga MZHE:

1. Ndërtesat publike, duke përfshirë stokun e ndërtesave administrative, arsimore, shëndetësore, dhe stokun e ndërtesave të kulturës dhe sportit.
2. Ndriçimi publik

Si konsumator tjerë fundor në komunën e Drenasit janë identifikuar edhe stoku i ndërtesave rezidenciale (të amvisërisë), stoku i ndërtesave komerciale dhe transporti. Komuna e

Drenasit nuk ka të dhëna dhe as juridiksion në menaxhimin e konsumit energjetik në këto sektorë, prandaj ka qenë i pamundur vlerësimi i konsumit energjetik të tyre.

Në kuadër të hartimit të këtij PKEE kemi shfrytëzuar një vegël të bazuar në programin Microsoft Excel për mbledhjen e të dhënave si për stokun e ndërtesave publike, ashtu edhe për ndriçimin publik.

Për stokun e ndërtesave publike janë mbledhur të dhëna për:

- Sipërfaqen bruto dhe sipërfaqen e ngrohur [66,189.60m²]
- Konsumin e energjisë elektrike në vit [855.772.00kWh/vit]
- Konsumin e energjisë për ngrohje në vit [9,112,852.20kWh/vit]
- Konsumin specifik të energjisë për ngrohje [137kWh/m²/vit]
- Llojin e sistemit të ngrohjes dhe burimi primar i shfrytëzuar kryesisht Biomasa, Thëngjilli, Nafta dhe Pelet

Për ndriçimin publik janë mbledhur të dhëna për:

- Konsumin e energjisë elektrike në vit [213.19MWh/vit]
- Lloji i trupave ndriçues, Trupat ndriçues janë kryesisht natrium 150W dhe ekonomik 60W
- Fuqia, numri dhe orët e punës në vit e trupave ndriçues sipas metodologjisë 4015h/vit

Në vijim janë paraqitur të dhënat e konsumit energjetik për sektorët e ndryshëm komunal.

4.2 Stoku i ndërtesave publike

Në komunën e Drenasit janë identifikuar 62 ndërtesa që janë pjesë e stokut të ndërtesave publike të destinuara për shërbime të ndryshme, si administrative, edukative, kulturore, shëndetësore dhe shërbime tjera. Konsumi total i energjisë për stokun e ndërtesave publike për komunën e Drenasit është rreth 0.85 ktoe.

Konsumi total për të gjithë sektorët në KK Drenasit është 9.96GWh/vit kjo njësi përpjesëtohet me faktorin 11.62 dhe kemi 0.85ktoe. shi. Bilancine Energjisë- konvertimi i njësive.

Kategorizimi për Komunën e Drenasit sipas konsumit specifik dhe energjisë totale

Ne rekomandojmë të kryhen auditime të energjisë për ndërtesa me konsum specifik më të lartë se 300 kWh/m².

Pasi konsumi specifik në disa shkolla është shumë i lart dhe po ashtu në spitale, Administrata është shumë e ulët, besojmë se ato nuk funksionojnë në temperaturë komforti. Prandaj rekomandojmë të kryhen auditime të energjisë për shkollat dhe spitalet e caktuara.

4.2.1 Stoku i ndërtesave administrative

Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë 2016-2022, Komuna e Drenas

Për stokun e ndërtesave administrative të komunës së Drenasit janë mbledhur të dhëna për gjithsej 6 objekte të ndryshme, duke përfshirë edhe ndërtesën për Punë Sociale


Siç shihet në tab. 4 në sektorin e administratës, konsumi i energjisë termike dhe elektrike është 309,588.26 kWh/vit.

Tab4.

Nr.	Ndërtesat e Sektorit të Administratës	Sipërfaqja m ²	Konsumi i Energjisë kWh Termike	Konsumi i Energjisë Elektrike kWh	Konsumi Specifik kWh/m ²
1	KK Drenas–Komuna Objekti i Ri	1960	148,000.00	18,905.00	71.73
2	Zyra vendit në Komoran	260	-	19,157.50	73.68
3	Zyra vendit në Terstenik	260	-	17,879.00	68.76
4	Zyra vendit në Dobroshec	20	-	16,790.500	839.52
5	Zyra vendit në Abri	16	-	18,222.00	1,138.87
6	Qendra për punë Sociale	257	51,729.26	18,905.00	71.73
Totali		2773	199,729.26	109,859.00	72.02

Për KK Drenas–Komuna Objekti i Ri, konsumi i energjisë specifike në këtë objekt është afër 71.73 kWh/vit, prandaj nëse krahasohet me Objektin e vjetër të komunës që ka qenë konsumi specifik 119 kWh/vit, del të jetë rreth 40% kursim të energjisë, ndërsa objektet e Administratës në fshatra Abri dhe Dobrashevcë konsumi i energjisë specifike është jashtë standardeve krahasuar me sipërfaqen e objekteve për ngrohje, siç shihet në tab. 4, në krahasim me sipërfaqen për ngrohje.

Konsumi specifik fig.



4.2.2 STOKU I NDËRTESAVE TË ARSIMIT

Ky stok numëron gjithsej 35 objekte me një sipërfaqe totale prej **57,597.60m²** dhe një konsum total energjetikelektrike dhe termike prej **8,850,587.00kWh/vit**

Tab.5. Konsumi energjetik në stokun e ndërtesave të arsimit

Nr.	Ndërtesa ne Sektorin e Arsimit	Sipërfaqja m ²	Konsumi i Energjisë Termike kWh	Konsumi i Energjisë Elektrike kWh	Konsumi Specifik kWh/m ²
1	QEAP "Ardhmëria" Drenas	550	88,174.88	14,613.00	160,32
2	QEAP "Ardhmëria" Paralelja në Komoran	300	52,904.93	13,145.00	176,34
3	SHFMU "Fazli Grajqevci"-Vasilevë	1285	95,065.45	8,713.00	73,98
4	SHFMU "Hasan Prishtina"-Llapushnik	854	193,146.39	6,681.50	226,16
5	SHFMU "Jusuf Gervalla-Negroc	878	194,976.79	5,636.00	222,06
6	SHFMU "Naim Frashëri"-Gllobar	1500	172,593.71	6,604.00	115,06
7	SHFMU "Shotë Galica"-Abri e Epërme -Shkolla Ame	1691	420,255.86	9,545.00	248,52
8	SHFMU "Shotë Galica"-paralelja në lagjen e muliqve	410	112,523.03	5,317.50	274.44
9	SHFMU "Zenel Hajdini-	3800	336,881.87	15,499.50	88,65

Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë 2016-2022, Komuna e Drenas

	Tërstenik				
10	SHFMU. "Gani Elshani"- Kroikovë	1640	189,284.43	10,908.50	115.42
11	SHFMU. "7 marsi "- Kizharekë	1400	325,190.40	16,799.50	232.27
12	SHFMU. "Ali Gashi"- Qikatovë e Re	2550	220,126.44	17,817.50	86.32
13	SHFMU. "Arif Shala"- Korroticë e Poshtme	1164	123,368.02	10,936.00	105.98
14	SHFMU. "Azem Bejta"- Shtuticë	880	186,744.99	5,999.50	212.21
15	SHFMU. "Xheladin Gashi"-Plaku "- Komoran	2464	301,807.46	18,408.50	122.48
16	SHFMU. "Bajram Curri"- Nekoc	1440	205,049.05	14,208.50	142.39
17	SHFMU. "Dëshmorët e Drenicës" Qikatovë e Vjetër	1141	176,746.48	10,736.00	154.91
18	SHFMU. " Dëshmorët e Fortesës- Vërboc	640	161,748.72	8,663.00	252.73
19	SHFMU. "Shaban Polluzha"- Polluzhë	560	150,750.36	3,490.50	269.19
20	SHFMU. "Rasim Këçina"- Drenasi	2753	547,009.80	57395.00	198.69
21	SHFMU. "Luigj Gurakuqi"- Sankoc	1568	188,437.95	14104.00	120.17
22	SHFMU. "Luigj Gurakuqi"- paralelja fushticë e poshtme	420	126,753.94	8,189.50	301.79
23	SHFMU. "Migjeni"- Baicë	1391	241,816.41	10,140.50	173.84
24	SHFMU. "Rilindja"- Dobroshec	1543	356,878.88	7,199.50	231.28
25	SHFMU. "Shaban Palluzha"- Korroticë e Epërme	1200	141,751.70	13,545.00	118.12
26	SHFMU. "Mehmet Gradica" - Gradicë	1010	166,747.95	5,440.50	165.09
27	SHFMU. "Xhevë Lladrovci" Gllanasellë	1200	147,211.07	8,695.00	122.67
28	SHFMU. "Abedin Bujupi "- Arllat	2300	452,314.78	17,290.50	196.65
29	SHFMU. "Dëshmorët e Qëndresës II "- Tërstenik II	1500	150,903.73	9,426.50	100.60
30	SHFMU. "Mehdi e Sylejman	880	124,214.50	2,990.50	141.15

Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë 2016-2022, Komuna e Drenas

	Bytyçi" -Bytyç				
31	SHFMU."Halil Bajraktari" - Drenas II	1326	296,808.21	12,236.00	223.83
32	SHFMU."Regjep Gjeli" Likoshan	537	114,215.99	2,749.50	212.69
33	SHFMU."Shotë Galica"- Tërdec	610	1,54,210.02	7,254.00	252.80
34	SHMT-Fehmi Lladrovci - Drenas	8870	976,804.05	37,304.00	110.12
35	SHML"Gjergj Kastrioti Skënderbeu"- Drenas	5706	648,687.84	61.113.00	113.68
Totali:		57,597.60	8,371,792.00	478,795.00	133.3


Bazuar në të dhënat mbi konsumin e energjisë ne sektorin e arsimit, konsumi total i energjisë është përenergjinë elektrike dhe termike është **8,850,587.00kWh/vit**, ndërsakonsumi specifik është **133,3 [kWh/ m²/vit]**

Në lidhje me konsumin e energjisë në shkollat e analizuara bie në sy konsumi i lartë në shkollën "SHFMU." Luigj Gurakuqi" në Fushtice të Epërme e ciladisponon ne vete **420 m²** hapësirë për ngrohje, konsumi specifik është **301.79[kWh/ m²/vit]**, është i lartë në krahasim me standardet e konsumit të energjisë specifike që është maksimum **110[kWh/ m²/vit]**, për këtë lloj te ndërtesave, rastin te ngjashëm e kemi edhe ne SHFMU "Shotë Galica"-paralelja në lagjen e Muliqve me sipërfaqe për ngrohje **410 m²** konsumin specifik i energjisë është **274.44[kWh/ m²/vit]**, siç shihet edhe ne diagramin fig. 5 ne konsumin e energjisë specifike.

Rekomandohet që të bahet aditimi i energjisë për Sektorin e arsimit në mënyrë që të identifikohen të gjitha masat e EE për të ndalur humbjen e energjisë.

Fig.5. Konsumi total specifik për stokun e ndërtesave të arsimit

Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë 2016-2022, Komuna e Drenas



4.2.3 Stoku i Ndërtesave të Shëndetësisë

Nga stoku i ndërtesave të shëndetësisë janë siguruar të dhënat nga zyrtaret komunal për 13 objekte. Nga të dhënat e paraqitura më poshtë, konsumi total përenejgjijnë termike dhe elektrike është **395,600.71 kWh/vit.**

Tab.6 Konsumi total energjetik në stokun e ndërtesave të shëndetësisë

Nr.	Ndërtesat e Shëndetësisë	Sipërfaqja m ²	Konsumi i Energjia Termike kWh	Konsumi i energjisë elektrike kWh	Konsumi Specifik kWh/m ²
1	Qendra Kryesore Mjekëses Familjare Drenas	2500	345346,67	189692,2	138,13
2	AMF Komoran	154	26689,23	24009,8	173,30
3	AMF Gllanasellë	288	19758,99	8781,3	68,61
4	AMF Terstenik	150	12590,74	8398,8	83.93
5	AMF Arllat	144	26689,23	4919,7	185.34


Plani Komunal për Efiçencë të Energjisë 2016-2022, Komuna e Drenas

6	AMF Baicë	88	13844,54	4054,2	157,32
7	AMF Sankoc	100	13344,61	1400,1	133,44
8	AMF Dobroshevc	120	13844,54	1845,2	115,37
9	AMF Abri	100	12844,69	1474,0	128,44
10	AMF Terdec	80	12844,69	3048,4	160,55
11	AMF Vasilevë	90	15844,24	1232,3	176,04
12	AMF Nekoc	70	13844,54	3927,8	197,77
13	AMF Gradicë	90	13844,54	1244,3	153,82
Totali:		3974	541,331.28	254,028.10	136.21

AMF Nekoc , del te jetë me konsum me te lart te energjisë 197,77kWh/m²/vit, e cila tregon se nuk është ne gjendje te mirë me Efiçencë të Energjisë. rastin e ngjashëm e kemi edhe ne AMF Arllat, me konsum specifik te energjisë 185.34Wh/m²/vit. Ndërsa si konsum total te energjisë termike dhe elektrike për sektorin e shëndetësisë është **795,359.38 kWh/vit**.

Edhe ne sektorin e Shëndetësisë rekomandohet të bëhet Aditimi i Energjisë.

Fig.7 Konsumi total specifik në stokun e ndërtesave të Shëndetësisë



Siç munde te shihet edhe ne diagram ne Fig. 7, gjendja jo e mirë

4.2.4 Stoku i ndërtesave nësektorin e kulturës dhe sportit

Nr.	Ndërtesat e Shëndetësisë	Sipërfaqja m ²	Konsumi i Energjia Termike MWh	Konsumi i energjisë elektrike MWh	Konsumi Specifik kWh/m ²
1	Salla e Kulturës	450	-	13.09	29.08
2	Palestra Sportive	1215	-	-	-
3	Biblioteka e Qytetit	180	-	-	-
Totali:		1,845.00	-	13,090.00	29.08

Numri i ndërtesave të sektorit të kulturës dhe sportit është 4në komunën e Drenasit, ne këtë sektor mungojnë te dhënat e konsumit tëenergjisë.

4.3 Ndriçimi Publik

Ndriçimipublik ne Komunën e Drenasitështë ne gjendje jo te mirë, por KK i Drenasit ka ber një hap shumë te drejt dhe te rëndësishëm ne këtë sektor pasi qe ka vendosur qe te gjithë trupat ndriçues ekzistues do ti zëvendësoj me LED 80W, 60W dhe 40W, e cila tanika nënshkruarkontratë me kompaninë te profesionalizuar ne ndriçim LED.

Nëkëtë rast do tënxjerrim konsumin e energjisë ne ndriçim publik te gjendjes ekzistuese nësëndriçimi do te punonte 100%, dhe pas zbatimit te masave te Eficiencës së Energjisë, siç shihet ne tabelën 8.

Kalkulimi i konsumit te energjisë ne ndriçim publik është ber ne baze te metodologjisëPoshtë Lart, te rekomanduar nga TKE, prandaj sipas metodologjisëndriçimi ne Kosovë punon 4015h/vit.

Tab.8 Konsumi total energjetik në sektorin e ndriçimitpublik dhe shpenzimet vjetorë

	Sasia	Fuqi/W	Shpenzimet e energjisë MWh/vit aktuale	Shpenzimet pas zbatimit te EE MWh/vit	Diferenca MWh/vit
	354	150 W	213.19	71	142
	56	60 W	13.49	4.49	9
To	410		226	75	151

Prandaj siç shihet me zbatimin e masave te eficiencës se energjisë kursimi do te jetë rreth**80%**, edhe pse do te vendoset sistemi LED, do te jete me SMART qe do ti ule shpenzimet deri ne 50% nga LED-i.

NDËRTHESAT REZIDENCIALE

Administrata e komunës së Drenasit nuk posedon regjistra të saktë mbi numrin dhe cilësi tjera të sektorit të banimit. Sipas të dhënave nga regjistrimi i fundit i popullatës në Kosovë, (2011), në komunën e Drenasit ekzistojnë: 8,434 shtëpi individuale banimi me sipërfaqe 751,917m² ndërsa 247 apartamente me sipërfaqe 18,092 m².

Sa i përket shtëpive individuale nuk ekziston legjislacion në fuqi i cili rregullon konsumin e energjisë në ato hapësira dhe as komuna nuk ka juridiksion mbi këtë pikë. Në përgjithësi këto ndërtesa karakterizohen me një mbështjellës të pa izoluar në një përqindje me të madhe ndërsa ndërtimin e ri është i izoluar. Mënyra kryesore e ngrohjes është me stufa individuale që djegin dru zjarri, thëngjill, në kohën e fundit ndërtesat e reja kanë të instaluar ngrohjen qendrore.

Ndërtesat shumë banesorë gjithashtu nuk janë në përgjegjësinë e komunës për të menaxhuar mirëmbajtjen e tyre dhe kjo është e rregulluar me ligjin mbi "Ligji për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi". Këto ndërtesa karakterizohen me mbështjellës të pa izoluar në aspektin termik. Konsumi i energjisë është kryesisht energji elektrike për ngrohje por edhe stufa individuale me dru. Komuna e Drenasit nuk ka ngrohtore të qytetit të instaluar, prandaj mënyra e ngrohjes realizohet kryesisht me energji elektrike dhe stufa klasike.

Sipërfaqja e shtëpive individuale sipas statistikave 2011 është 90m²

Sipërfaqja e apartamentit sipas statistikave 2011 është 73m²

Sipas anketës vetëm 36% e shtëpive kanë izolim të mureve dhe vetëm 47% e tyre kanë dritare me dy xhama.

Potenciali për kursim në sektorin e ndërtesave rezidenciale

Në kuadër të ndërtesave rezidenciale potenciali për kursim të energjisë është i madh, në kalkulim është marrë i tërë stoku i ndërtesave shtëpitë individuale dhe apartamentet

Kursimi i mundshëm në Sektorin Rezidencial:

Kursim i energjisë [MWh/vit] 25,866

Redukim i [tCO₂] 15,676

Kursimi [%] 20

Shpërfaqë për renovim [m²] 538,880

Investimi [euro] 21,555,212

Potenciali për kursim nga Transporti

Kursimi në transport do të mund të arrihet me rregullimin më eficient të trafikut masiv komunal. Komuna duhet të hartoj Planin e Mobilitetit të komune me anë të cilit do të rregulloheshin Linjat e trafikut, parkingjet etj/

Kursimi i mundshëm në transport:

Kursim i energjisë [MWh/vit] 492

Redukim i [tCO₂] 146

Kursimi [%] 10

Investimi [euro] 800,000

5.4 Përmbledhje e konsumit energjetik

Në tabelën e mëposhtme është dhënë i përmbledhur konsumi total energjetik për vitet 2014 dhe 2015 për sektorët komunal. Nga të dhënat del që mesatarisht këto sektorë shpenzojnë **9,968,850.26 kWh/vit** energji elektrike dhe energji për ngrohje.

Tab.9 Konsumi total energjetik në sektorët komunal në Drenasë

Sektori	Konsumi i energjisë [kWh/vit]
Ndërtesat Administrative	309,588.26
Ndërtesat Arsimore	8,850,587.00
Ndërtesat Shëndetësore	795,359.00
Ndërtesat e kulturës dhe sportit	13,090.00
Ndriçimi Publik	226
Totali	9,968,850.26

5

STRATEGJIA PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Strategjia për eficiencë të energjisë është definuar duke u bazuar në potencialin për kursim të energjisë, dalë nga të dhënat mbi konsumin energjetik në sektorët komunal të Drenasit. Kjo pjesë e PKEE paraqet njohurit edhe pjesën më të rëndësishme të planifikimit dhe përbëhet nga aktivitete dhe masa praktike të cilat duhet që Komuna e Drenasit së bashku me akter të tjerë si AKEE-ne, t'i ndërmarr në mënyrë të vazhdueshme për shfrytëzimin maksimal të potencialit për kursim energjetik.

Strategjinë tonë për eficiencë të energjisë e kemi menduar ta zhvillojmë nëpër hapat e paraqitur si më poshtë:




Fig.11 Strategjia për eficiencë të energjisë e komunës së Drenasit

5.1 Ndarja e resurseve financiare, organizative dhe humane për fushën e EE

Edhe në Komunën e Drenasit, ashtu sikurse edhe në Komunitet të tjerë të Kosovës, ka munguar si fondi i dedikuar komunal ashtu edhe ekipi apo Zyra Komunale për Energji, të dyja këto masa të domosdoshme për implementimin e çfarëdo aktiviteti nga fusha e energjisë në kuadër të komunës.

- Fondi komunal për EE: krahas burimeve të tjera, fondi komunal do të jetë mbështetja financiare e Komunës për implementimin e masave dhe aktiviteteve në fushën e EE. Me ndarjen e një fondi të tillë dëshmohej gatishmëria dhe synimi i Komunës që këtë plan ta kthejë në veprim.
- Themelimi i një ekipi të energjisë apo ZKE: me ZKE do të krijohet një strukturë ekzekutive me përgjegjësi dhe detyra të definuar qartë në kuadër të Komunës. Përveç

planifikimit dhe implementimit të masave të ndryshme të eficiencës së energjisë, ekipi komunal do të përcjellë edhe performancën energjetike të sektorëve të ndryshëm konsumues si dhe do të shërbenë si hallkë komunikimi ndërmjetëm autoriteteve vendim-marrëse dhe hisedarëve (stakeholders) të ndryshëm.

5.2 Vlerësimi i performancës energjetike

Mbledhja e të dhënave mbi konsumin energjetik aktual dhe të vitevetë kaluara është hapi i parë drejtë identifikimit të mundësive për përmirësimin e performancës energjetike dhe përfitimeve financiare që dalin nga intervenimet e tilla.

Vlerësimi i performancës energjetike të sektorëve të ndryshëm komunal do të bëhet në baza periodike dhe do të kaloj nëpër dy faza:

1. Mbledhja e të dhënave të konsumit: ekipi komunal për energji duhet të krijoj sistemin komunal për mbledhjen e informacioneve mbi konsumin energjetik. Këto informacione duhet të jenë të plota dhe të sakta pasi që në bazë të tyre do të vendosen edhe caqet për kursim dhe masat EE për t'u ndërmarrur.
2. Analiza e të dhënave: të dhënat e mbledhura pastaj do t'iu nënshtrohen fazës së analizës dhe vlerësimit me ç'rast do të kuptohen karakteristikat dhe trendet e konsumit energjetik. Gjithashtu në këtë fazë do të bëhet vlerësimi i performancës energjetike dhe identifikimi i potencialeve për kursim.

5.3 Plani i Veprimit

Me rastin e përfundimit të fazës së mbledhjes së të dhënave për sektorët e ndryshëm konsumues në kuadër të komunës, vazhdohet me hartimin e një plani të veprimit nëpërmjet të cilit do të arriheshin objektivat, në vazhdim është paraqitur plani i veprimit, buxhet i aprovuar i cili do të shpenzohet për implementim të projekteve me masa të EE-së, për vitin 2016, dhe planifikimi i buxhetit për projektet që parashihren të implemtohen me masa efikiente për vitet 2017-2022

- Zgjedhja e masave teknike për t'u implementuar
- Ndarja e resurseve dhe përgjegjësi

Nr	Emri i projektit	Lloji i masës	Burimet e financimit	Vlera e financimit në €	Përiudha e implementimit	Mekanizimi i monitorimit
1	Rregullimi i nxemjes Qendrore në SHFMU "Gani Elshani" Krahovë	Instalimi i ngrohjes qendrore	Komuna / Drejtoria e Arsimit	30,000 €	Gjashtëmuorin e dytë të vitit 2016	Zyrtaret e drejtoriverespektive
2	Renovimi i SHFMU "Mehdi Sylejman Bytyqi" Bytyq	Ndërtimi i dritareve dhe izolimi i kulmit	Komuna / Drejtoria e Arsimit	15,000 €	Gjashtëmuorin e dytë të vitit 2016	Zyrtaret e drejtoriverespektive
3	Rregullimi i nxemjes qendrore në SHFMU "Zenel Hajdini" Terstenik	Instalimi i ngrohjes qendrore	Komuna / Drejtoria e Arsimit	30,000 €	Gjashtëmuorin e dytë të vitit 2016	Zyrtaret e drejtoriverespektive

Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë 2016-2022, Komuna e Drenas

4	Renovimi Shfmu "Luigj Gurakuqi" Fushtice e Poshtme	Ndrrimi i dyshe mes	Komuna /Drejtoria e Arsimit	10,000 €	Gjashtmuja e dytë e vitit 2016	Zyrtaret e drejtoriverespektive
5	Rregullimi i nxemjesqendror e ne SHFMU "Xheva Lladrovci" Gllanaselle	Instalimi i ngrohjesqendrore	Komuna /Drejtoria e Arsimit	15,000 €	Gjashtmuja e dytë e vitit 2016	Zyrtaret e drejtoriverespektive
6	Renovimi i dysheve ne Shfmu Abedin Bujupi Gjergjiç	Hidriizolim i dhjetërmoizolimi i dysheve të kështjellës	Komuna /Drejtoria e Arsimit	15,000 €	Gjashtmuja e dytë e vitit 2016	Zyrtaret e drejtoriverespektive
7	Renovimi i sallës së kultures	Izolimi i mureve të sallës	Komuna /Drejtoria e Kulturës	20,000 €	Gjashtmuja e parë e vitit 2016	Zyrtaret e drejtoriverespektive
8	Renovimi i QMF Arllat	Ndrrimi i dritareve dhe izolimi i kulmit	Komuna /Drejtoria e Shendetësisë dhe Mirëqenjes sociale	20,000 €	Gjashtmuja e dytë e vitit 2016	Zyrtaret e drejtoriverespektive
9	Renovimi i QKMF	Përmirësimi i instalimeve të ngrohjes, instalimi i evetëujit, sidhe punëtjër të nevojshme	Komuna /Drejtoria e Shendetësisë dhe Mirëqenjes sociale	70,000 €	Gjatë vitit 2016	Zyrtaret e drejtoriverespektive
10	Renovimi i ndriqimit publik me sistemin inteligjent të komandimit dhe trupandriqes me llamba LED	Ndrrimi i tripavendriqes me llamba LED	Komuna/Drejtoria për Sherbime publike dhe emergjencë	75,000.00	Gjatë vitit 2016	Zyrtaret e drejtoriverespektive
	Rregullimi i ndriqimit publik në Qikatovtevjeter me Trupandriqes me llamba LED	Rregullimi i ndriqimit publik me shtylla dhe Trupandriqes me llamba LED	Komuna/Drejtoria e Urbanizmit	20,000.00	Gjatë vitit 2016	Zyrtaret e drejtoriverespektive
	Totali			320,000.00 €		

Drejtoria e Arsimit	B. aprovu. Buxheti planifikuar		
Shpenzimet Kapitale	2017	2018	2019
Shpenzimet Kapitale			
Rregullimi i nxemjesqendrore SHFMU "Shotë Galica" Terdevc		30,000.00	
Renovimi i dysheve SHFMU "Abedin Bujupi" paral. Gjergjiç			
Rregullimi i nyjeve sanitare ne SHFMU "Gani Elshani" Kroikovë		15,000.00	
Rregullimi i nxemjesqendrore në SHFMU "Xhevë Lladrovci" Shkabë	15,000.00		
Rregullimi i nxemjesqendrore në SHFMU "Mehmet Gradica", Gradicë	26,791.00		
Renovimi i objektit (aneksi I vjetër) ne SHFMU "Deshmoret e Qëndresës" Terstenik II		50,000.00	

Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë 2016-2022, Komuna e Drenas

Vazhdimi i punimeve të aneksit në SHFMU „ Dëshmoret e Fortesës "Verboc		10,000.00		
Ndërtimi i Dritareve në SHFMU „Fazli Graiqevci" në Vasileve		10,000.00		
Rregullimi i nxemjesqendrorenë SHFMU „ Gani Elshani" Kroikove				
Rregullimi i nxemjesqendrorenë SHFMU "Azem Bejta", Shtuticë			30,000.00	
Rregullimi i nxemjesqendrorenë SHFMU "Shaban Polluzha", Polluzhë			30,000.00	
Rregullimi i nxemjesqendrorenë SHFMU „ Dëshmoret e Fortesës "Verboc			30,000.00	
Rregullimi i nxemjesqendrorenë SHFMU "Rexhep Gjeli" Likoshan			30,000.00	
Rregullimi i nxemjesqendrorenë SHFMU "Shotë Galica" Abriparal. Lagjeja e Muliqve			30,000.00	
Rregullimi i rrethjes në SHFMU "Shotë Galica" Abriparal. Lagjeja e Muliqve				30,000.00
Rregullimi i nxemjesqendrorenë SHFMU " Mehdi e Sylejman Bytyqi " Bytyq			30,000.00	
Renovimi i SHFMU " Mehdi e Sylejman Bytyqi " Bytyq		20,000.00		
Renovimi i objekteve në shkollë .		20,000.00	23,903.00	20,000.00
Renovimi i objektit të SHFMU "Luigj Gurakuqi "- paralelja Fushticë e Poshtme				
Ndërtimi i një Qerdhëpërfëmijësh në Drenas				300,000.00
Renovimi i dyshemesë SHFMU „ Luigj Gurakuqi "paralelja Fushticë e Poshtme				
Rregullimi i nxemjesqendrorenë SHFMU „ Zenel Hajdini" Terstenik				
Total		101,700.00	268,000.00	350,000.00

Planifikimi i Buxhetit për Drejtorin e Administratës	2017	2018	2019
Renovimi i ZGJC në Komoran			45,000.00
Renovimi i ZGJC në Terstenik		26,000.00	
		26,000.00	45,000.00
Drejtori për Planifikim Urban dhe Mbrojtjet e Mjedisit	2017	2018	2019
Rregullimi i ndriqimit Publik me sistemin inteligjent në Qikatovët e Vjetër dhe Komoran	130,000.00		

Planifikimi I Buxhetit për Shendetësi dhe mirëqenje sociale				
		2017	2018	2019
1	Renovimi I QKMF -	50,000.00	50,000.00	50,000.00
2	Ndertimii QMF. Komoran	100,000.00	100,000.00	
3	Zgjerimii QMF. Baicë		10,000.00	
4	Zgjerimii QMF. Terstenik		10,000.00	
5	Renovimii QMF Arllat	20,000.00		
12	Instalimi I nxemjes solare ne QKMF			100,000.00
	Gjithsej:	170,000.00	161,000.00	150,000.00

5.3.1 Zgjedhja e masave teknike

Vlerësimi i performancës energjetike nëpërmjetpërforcimit të auditimeve energjetike është parakusht për ndërmarrjen e çfarëdo veprimi në drejtim të përmirësimit të gjendjes së eficiencës së energjisë në komunë. Nëpërmjet auditimit do të identifikohet saktësisht konsumi energjetik dhe masat e nevojshme për t’u ndërmarrur me qëllim të arritjes së kursimeve në të ardhmen.

Në vijim është dhënë lista e disa prej masave të cilat konsiderohen si më kosto-efektive sipas studimit të Institutit të Bankës Botërore^[4], në përputhje me rekomandimet e BE-së dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, dhe të cilat masa janë paraparë të implementohen edhe në komunën e Drenasit.

Renovimi i mbështjellësit nëpërmjet izolimit termik të mureve të jashtme dhe pullazit


Urat termike janë zona(hapësira) të vogla në pjesën e ngrohur të mbështjellësit të ndërtesës nëpër të cilat rrjedha e ngrohjes ndryshon për shkak të ndryshimit të materialit, trashësisë ose formës gjeometrike të tij dhe paraqesin shkaktarin më të madh të humbjeve dhe të fitimit të nxehtësisë nëpërmjet mbështjellësit për gati të gjitha llojet e ndërtesave. Minimizimi i këtyre urave arrihet nëpërmjet mbylljes së vrimave dhe hapësirave me shtresa të ndryshme të materialeve termoizoluese në bazë të polistirenit të ekspanduar dhe leshit mineral.



Shfrytëzimi i dritareve me xham të dyfishtë/trefishtë

Dritaret me xham të dyfishtë/trefishtë ndërtohen duke alternuar shtresat e xhamit dhe ajrit (xham + 8-12 mm ajr + xham). Për të shtuar efektin izolues xhamat kufizohen në korniza nga alumini dhe PVC (polivinil kloruri) me profile termoizoluese.

Nëpërmjet kësaj mase zvogëlohet shkëmbimi i nxehtësisë nëpërmjet dritareve si njëra ndër pjesët me shkallën më të lartë të shkëmbimit në tërë ndërtesën.



Renovimi i sistemit të ngrohjes

Eficienca e sistemit të ngrohjes mund të përmirësohet nëpërmjet: përdorimit të kalldajave eficientë, përmirësimit të termoizolimit të kalldajës dhe gypave si dhe inkuadrimi i sistemeve automatike për kontroll të operimit.

Kalldajat që shfrytëzojnë për karburant materialet në gjendje të lëngët dhe të gazët mundësojnë djegie të tërësishme dhe stabile të karburantit duke rritur kështu eficiencën e sistemit. Gypat e pa izoluar bëjnë që nxehtësia e gjeneruar nga kalldaja gjatë bartjes të humbet në mjedisin përreth, ku sa më e madhe të jetë diferenca në temperaturë ndërmjet gypave dhe rrethinës aq më e madhe do të jetë kjo humbje e nxehtësisë. Një masë tjetër në sistem të ngrohjes së objektit është edhe automatizimi i tij nëpërmjet:


- Kontrollit të djegies nëpërmjet të të ashtuquajturave sonda llambda
- VSD(Variable Speed Drive) kontroll i pompave dhe ventilatorëve
- Shprazje automatike e kalldajave për evitim të papastërtive dhe korrozionit
- Vendorsja e valvolave termostatike në kombinim me instrumente për matjen e temperaturës së ajrit jashtë dhe brenda kalldajës si dhe matjen e temperaturës së ujit të ngrohtë në kalldajë.



Sistemet fotovoltaike


Efekti fotovoltaike është procesi i konvertimit direkt të rrezatimit diellor në elektricitet nëpërmjet celulës fotovoltaike, e ndërtuar nga materiale gjysmëpërçuese, të cilat kanë aftësinë e gjenerimit të rrymës elektrike kur ekspozohen ndaj dritës direkte. Shumë celula bashkohen në njësi të quajtura module të cilat pastaj lidhen me njëri tjetrin në radhë.

Modulët fotovoltaike mund të vendosen në konfiguracione të ndryshme në tokë, mbi pullaze dhe në shtylla. Më poshtë është dhënë skema tipike e një sistemi të ashtuquajtur stand-alone i pavarur nga rrjeti kombëtar energjetik.



Sistemet fotovol

taike gjenerojnë energji të pastër pa efekte të dëmshme në mjedis. Megjithatë si masë ka periudhë më të gjatë të kthimit të investimit, krijimi i tarifës nxitëse e cila parashihet të dalë së shpejti, do të ndihmojë në mbulimin më të shpejtë të investimit.



Panelet solare për ngrohjen e ujit

Sistemet e paneleve solare mund të shfrytëzohen për dy funksione: ngrohjen e ujit sanitar dhe si burim suplementar për ngrohjen e hapësirave.

Në panele solare, rrezatimi diellor shndërrohet në energji termike e cila mund të konzervohet në rezervuar në formë të ujit të ngrohët. Uji i ngrohur nga panelet solare mund të ngrohet edhe më tutje nëpërmjet kalldajës deri në temperaturën e nevojshme për ngrohjen e hapësirave.

Ndriçimi dhe kontrolli i ndriçimit në hapësirat e brendshme

Në kuadër të masave për t'u aplikuar në objekte është edhe ndërimi i poçave inkadeshent me ata fuoroshent të cilët konsumojnë dukshëm më pak energji elektrike.

Gjithashtu mund të shfrytëzohen edhe sensor të prezencës të cilët automatikisht do ta ndiznin dritën me rastin e detektimit të lëvizjes. Kjo masë do të ndikojë në rënje drastike të konsumit të energjisë elektrike për ndriçim në një objekt.

Masat e eficiencës së energjisë në ndriçimin publik

Ofrimi i ndriçimit publik paraqet një rën nga përgjegjësitë më të rëndësishme dhe njohurit më të vështira të institucioneve komunale. Ndriçimi publik llogaritet dikur rreth 10-38% të tërës konsumit energjetik në qytete tipike në botë. Ndriçimi jo-eficient shkakton humbje të mëdha financiare për çdo vit, ndërsa ndriçimi i dobët rritë pasigurinë e qytetarëve në rrugë.

Dy masat më të rëndësishme për t'u implementuar në ndriçimin publik janë:

- Mirëmbajtja sistematike
- Ndërrimi i trupave ndriçues të teknologjive të vjetruara me ato më moderne dhe më Eficiente siq janë Led llambat.
- **Insatimi i sistemit inteligjent për komandim dhe monitorim të ndriçimit publik.**

Pjesa dërmuese e rrugëve dhe hapësirave të ndriçuara në komunën e Drenasit janë me trupa ndriçues nga natriumi me fuqi 150W dhe ekonomike. Ndriçimi publik modern në kohët e fundit kryesisht është orientuar drejt trupave ndriçues LED si fjala e fundit e ndriçimit kualitativ. Përparësi e ndriçimit LED është se jetëgjatësia shumë më e madhe (100,000.00orë), kosto e reduktuar për mirëmbajtje dhe ndriçim kualitativ me ngjyrë të bardhë.

Zbatim i masave të EE në ndriçim publik sot mund të arrihet deri në 80%, përmes sistemit LED, duke pasqyruar gjendjen jo të mirë të ndriçimit publik në Kosovë do të kemi kursim dukshëm të energjisë dhe kualitet (efekt më të mirë të ndriçimit), siç mund të shihet në fig. me poshtë në zbatimin e masivë të EE në ndriçim publik një nga rrugët e realizuara në Kosovë



Fig. 1 Para masave të EE të 150W (Presion të lartë High)

Fig. 2 Pas masave të EE në LED 50W

6

VLERËSIMI I POTENCIALIT PËR KURSIM

Në vijim të këtij kapitulli është dhënë potenciali i vlerësuar për kursim energjetik për sektorë të ndryshme të komunës së bashku me vlerat e nevojshme të investimit kumulativ për periudhën 2016-2022.

Për vlerat njësi të investimit të masave teknike në stokun e ndërtesave publike, janë shfrytëzuar të dhënat e ofruara në raportin e Institutit të Bankës Botërore^[4]. Vlerat njësi të dhëna më poshtë janë për masa të llogaritura si kosoto-efektive për stokun e ndërtesave në Kosovë.

Masa EE	Investimi [€/njësi]	Ndërtesat rezidenciale	Ndërtesat komunale
Izolimi termik i mureve të jashtme	Euro/m ²	20	18
Izolimi i pullazit	Euro/m ²	35	32
Dritare EE	Euro/m ²	100	90
Sistem EE i furnizimit me ngrohje	Euro/m ²	35	32
Ngrohës EE i ujit sanitar	Euro/njësi	200	2000
Sistem solar i ngrohjes së ujit	Euro/njësi	1600	15000
Poça efiçient LED	Euro/njësi	10	10
Pajisje shtëpijake EE	Euro/njësi	380	4000

Tab.10 Vlerat njësi të investimit për masa EE

6.1 Potenciali për kursim në stokun e ndërtesave administrative

Stoku i ndërtesave administrative karakterizohet me një konsum specifik prej 72.02kWh/m²/vit. Kjo vlerë është dukshëm më e lartë se sa vlera e llogaritur për komfort prej kWh/m²/vit, prandaj investimi në këtë stok do të sillte kursim të madh energjetik.

Në kuadër të këtij sektori kemi paraparë implemetim të masave EE si izolimi termik, renovimi i sistemit të ngrohjes, sistemit elektrik dhe të sistemit të ndriçimit në rreth 40% të sipërfaqes totale.

Ndërtesat Administrative		Masat EE
Përqindja e sipërfaqes ku do të implementohen masat EE	40%	Izolimi termik: muri/tavani/dritare Renovimi/ndërrimi i sistemit të ngrohjes Renovimi i sistemit elektrik dhe i ndriçimit
Periudha kohore	2016-2022	
Investimi [euro]	93,060.00	
Kursimi në % të konsumit total final	30%	
Kursimi[kWh/vit]	92,876.48	
Koha e kthimit të investimit [vite]	7	
Burimi i investimit	Donatoret te ndryshëm, IPA, Investim vetanak dhe përmes super ESCO	

Tab.11 Potenciali për kursim dhe investimi në stokun e ndërtesave administrative

6.2. Potenciali për kursim në stokun e ndërtesave të arsimit

Shkollat dhe institucionet tjera arsimore të komunës së Drenasit karakterizohen me një konsum specifik prej 145,34kWh/m²/vit, vlerë e ulët se sa ajo e llogaritur për kushte të komfortit prej 311 kWh/m²/vit. Pra në këtë stok është i domosdoshëm intervenimi me masa EE për sigurim të gjendjes së komfortit.

Ne baze te dhënave te grumbulluara ne KK Drenasit del te jete se duhet te zbatohen masat e EE edhe 40% deri në vitin 2021të sipërfaqes totale të stokut.

Tab.12 Potenciali për kursim dhe investimi në stokun e ndërtesave arsimore

	Ndërtesat Arsimore	Masat EE
Përqindja e sipërfaqes ku do të zbatohen masat e EE	40%	
Periudha Kohore	2016-2021	
Investimi [euro]	952,302.72	Izolimi termik: muri/tavani/dritare
Kursimi në % të konsumit total final	35	Renovimi/ndërrimi i sistemit të ngrohjes
Kursimi[kWh/vit]	2,655,176.10	Renovimi i sistemit elektrik dhe i ndriçimit
Koha e kthimit të investimit [vite]	9	
Burimi i investimit	Donatoret te ndryshëm, IPA, Investim vetanak dhe përmes super ESCO	

6.3. Potenciali për kursim në stokun e ndërtesave të shëndetësisë

Ndërtesat shëndetësore, nga të dhënat e konsumit energjetik, kanë rezultuar të kenë konsum specifik prej 0.13 kWh/m²/vit. Konsumi specifik për të siguruar komforin është llogaritur të jetë rreth 335 kWh/m²/vit. Vërehet konsum specifik dukshëm më i ulët se sa ai i nevojshëm për komfor, prandaj edhe në këtë stok, ashtu sikurse edhe tek stoku i ndërtesave arsimore është i domosdoshëm intervenimi me masa të eficiencës së energjisë.

Është paraparë investim në 70% të stokut të këtyre ndërtesave me masa EE si izolimi termik, renovim i sistemeve të ngrohjes, elektrik dhe të ndriçimit.

Ndërtesat shëndetësore		Masat EE
Përqindja e sipërfaqes ku do të zbatohen masat e EE	70%	
Periudha kohore	2016-2022	
Investimi [euro]	146,080.00	Izolimi termik: muri/tavani/dritare
Kursimi në % të konsumit total final	35	Renovimi/ndërrimi i sistemit të ngrohjes
Kursimi[kWh/vit]	238,607.70	Renovimi i sistemit elektrik dhe i ndriçimit
Koha e kthimit të investimit [vite]	13	

Tab.13 Potenciali për kursim dhe investimi në stokun e ndërtesave të shëndetësisë

6.4 Potenciali për kursim në stokun e ndërtesave të kulturës dhe sportit

Te dhënat për Stokun i ndërtesave të kulturës dhe sportit në komunën e Drenasit mungojnë

Ndërtesat e kulturës dhe sportit		Masat EE
Përqindja e sipërfaqes ku do të zbatohen masat e EE	50%	
Periudha kohore	2016-2022	
Investimi [euro]	70,625.00	Izolimi termik: muri/tavani/dritare
Kursimi në % të konsumit total final	30%	Renovimi/ndërrimi i sistemit të ngrohjes
Kursimi[MWh/vit]	3.92	Renovimi i sistemit elektrik dhe i ndriçimit
Koha e kthimit të investimit [vite]	15	

Tab.14 Potenciali për kursim dhe investimi në stokun e ndërtesave të kulturës dhe sportit

6.5. Potenciali për kursim në ndriçim publik

Në kuadër të ndriçimit publik është paraparë realizimi i një vargu të projekteve, të cilat kryesisht do të koncentrohen në zëvendësimin e trupave ekzistues të ndriçimit me teknologji më eficiente siç janë llambat LED.

Gjithashtu është paraparë investim në mirëmbajtjen vjetore të tërë rrjetit si dhe instalim i rreth 50 trupave ndriçues solar.

Ndriçimi Publik		Masat EE
Numri i trupave ndriçues	410	
Periudha kohore	2016-2017	
Investimi [euro]	90,000.00	Instalimi i trupave ndriçues LED
Kursimi në % të konsumit total final	80	Mirëmbajtja
Kursimi [MWh/vit]	151	Sistem inteligjentpërmes kontroll automatik përmes instalimit te sensorëve të prezencës dhe timer-ve digjital dimming etj.
Koha e kthimit të investimit [vite]	3	

Tab.15 Potenciali për kursim dhe investimi në sektorin e ndriçimit publik

6.6 Përmbledhje e potencialit për kursim në komunë

Spektori	Kursimi [MWh/vit]	Kursimi [%]	Reduktimi i CO2/t/vit	Investimi [euro]
Ndërtesat administrative	92.87	35	170.68	92,876.48
Ndërtesat arsimore	2,655.17	35	1,241.06	952,302.72
Ndërtesat shëndetësore	238.61	30	181.24	146,080.00
Ndërtesa e kulturës/sportit	3.92	35	5.13	70,625.00
Ndriçimi publik	151	80	0.197	90,000.00
Totali	3,141.57	42	1,645.69	1,351,884.20

Tab.16 Potenciali për kursim dhe investimi total komunal deri në vitin 2021

7

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Krahas zbatimit të masave EE të parapara në këtë plan, ZKE ose ekipi komunal përgjegjës për fushën e energjisë në kuadër të Komunës së Drenasit do të ketë për detyrë për monitorim dhe raportim, i cili në themel do të ketë arritjen e dy objektivave kryesore: vlerësimin e vazhdueshëm të konsumit energjetik në sektorët komunal si dhe vlerësimin e progresit të aktiviteteve dhe masave të parapara në raport me caqet e vendosura në planin e veprimit kombëtar.

Nëpërmjet Monitorimit dhe Raportimit do të mblidhen të dhëna të cilat do të ndihmojnë në hartimin e planit të dytë të veprimit, identifikimin e praktikave më të mira për t'u ndjekur në të ardhmen si dhe do të ndihmojë në vendosjen e caceve të reja të kursimit për komunën.

7.1 Matja e Përformancës

Mbledhja sistematike e të dhënave të konsumit energjetik, e organizuar në mënyrë periodike është e një rëndësie kruciale për të identifikuar konsumuesit më pak eficient tek të cilët është e nevojshme intervenimi, dhe në bazë të këtyre të dhënave të vlerësohet përformanca e masave dhe projekteve të realizuara dhe rezultatet e arritura.

Mbledhja sistematike e të dhënave të konsumit do të realizohet nga nivelet menaxheriale të sektorëve të ndryshëm komunal, nën mbikëqyrjen dhe asistencën e vazhdueshme të ZKE apo Ekipit Komunal për çështjet e energjisë. Lloji dhe periodiciteti i mbledhjes së të dhënave do të përcaktohet varësisht prej llojit të sektorit konsumues.

Të dhënat e mbledhura do të ruhen në formë të bazave të të dhënave për t'u kaluar pastaj në fazën e analizës dhe shqyrtimit nga ana e ZKE apo ekipit përgjegjës komunal.

VII.2 Rishikimi i planit të veprimit

Nëpërmjet rishikimit të planit të veprimit do të identifikohen faktorët mbrapa sukseseve ose dështimeve në realizimin e projekteve apo masave të caktuara EE, për të regjistruar masat e rezultuara si më të sukseshme si masa për tu realizuar edhe në të ardhmen.

Gjatë rishikimit të planit të veprimit si burim i informacioneve do të shfrytëzohet feedback-u nga matja e përformancës. Ky feedback do të vie jo vetëm nga realizimi i masave të caktuara EE por edhe nga regjistrimi i efekteve anësore/sekondare që aktivitetet e menaxhimit të energjisë kanë sjellur në mjedisin ku janë realizuar si: rritja e komfortit, reduktimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe operimit, përmirësimi i vetëdijës qytetare për rëndësinë e EE etj.

8

PËRMBLEDHJE

Nëpërmjet realizimit të masave të parapara në këtë plan, Komuna e Drenasit synon të arrijë cakun e kursimit prej 27% të konsumit energjetik total deri në vitin 2022. PKEE do ti shërbejë komunës tonë në reduktimin e shpenzimeve për shërbime energjetike dhe do ta identifikoj Komunën e Drenasit si një komunë e cila mbështetë dhe promovon eficiencën e energjisë.

Komuna e Drenasit në bashkëpunim me institucionet relevante, do të jetë përgjegjëse që t'i realizoj masat e parapara në këtë PKEE nëpërmjet regjistrimit vjetor të konsumit energjetik dhe planifikimit të projekteve EE. Fondet për realizimin e asaj që është paraparë në këtë plan, do të sigurohen nëpërmjet granteve dhe investimeve kapitale nga ana e vetë Komunës.

REKOMANDIM I PËRGJITHSHEM NË LIDHJE ME STOKUN E NDËRTESAVE

Stoku ekzistues i ndërtesave publike është në kushte shumë të dobëta sa i përket termoizolimit, si pasojë të gjitha institucionet energjetike të angazhuara në kursimet e energjisë duhet të kenë këtë çështje si problem crucial siç është përshkruar në Strategjinë e Energjisë së Kosovës dhe Plani Nacional i Kosovës për Eficiencën e Energjisë.

Përmirësimi i stokut ekzistues të ndërtesave nga këndvështrimi termoizolues dhe ndërtimi i ndërtesave të reja publike duke u bazuar në kodin e ri energjetik (që është

duke u përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Kosovë) do të mundësoj kursimin e burimeve të energjisë që përdoren për ngrohje dhe ftohje.

Në anën tjetër, kursimi i energjisë i cili rezulton si pasojë e instalimit të izolimit termik do të mundësoj përdorimin e burimeve më të pakta të energjisë për të përmbushur nevojat e ngrohjes.

REFERENCAT

1. Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (2010-2018)-MZHE, 2011
2. Ligji për Eficiencën e Energjisë, MZHE, 2011
3. Strategjia e Ngrhjes e Republikës së Kosovës, MZHE, 2011
4. National Building Energy Efficiency Study for Kosovo, World Bank Institute, 2013
5. Kosovo Household Energy Consumption- AUK, 2013
6. Regjistrimi i popullësisë dhe i ekonomive familjare, REKOS 2011
7. Studim mbi shpërndarjen e konsumit në sektorin e shërbimeve, MZHE,